KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Këshilli i Bashkësisë Islame, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbete në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-569/2021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-443/2021 të datës 23.08.2021 dhe shfuqizimin Autorizimin Nr. 01-407/2021 të datës 22.07.2021, nxjerr:

V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET:** Vendimit Nr. 01-443/2021 të datës 23.08.2021 për formimin e Grupit punues për kontrollimin e dokumenteve të cilat kanë të bëjë me fushën e urbanizmit sipas ligjit dhe akteve nënligjorë në fuqi dhe nga data 14.10.2021 punët mund ti kryejnë zyrtarët e urbanizmit.
2. Shfuqizohet Autorizimi Nr. 01-407/2021 i datës 22.07.2021, i cili ka autorizuar Dukagjin Hoxhaj, Zyrtar për Adresa në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Mjedis që ti pranoj të gjitha kërkesat drejtuar kësaj Drejtorie dhe nga data 14.10.2021 kërkesat mund ti pranojnë Drejtoria.
3. Shfuqizohet Autorizimi Nr. 01-414/2021 i datës 27.07.2021, i cili ka autorizuar Dukagjin Hoxhaj, Zyrtar për Adresa në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Mjedis që të nënshkruaj të gjitha shkresat dhe dokumentacionet që nxirren në këtë Drejtori dhe nga data 14.10.2021 shkresat dhe dokumentacionet do ti nënshkruaj zyrtari përgjegjës në këtë drejtori.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupit punues dhe Dukagjin Hoxhaj.
5. Vendimi është për perfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Grupit punues, Dukagjin Hoxhaj, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Mjedis dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Istogut

Opština Istok / Municipality of Istog

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 568/21

Me datë: 13.10.2021

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 68 të Statutit të Komunës së Istogut nr. 01 nr. 62/10, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Istogut, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të të hyrave komunale dhe menaxhimit të pasurive jo financiare kapitale dhe jo kapitale, si pjesë përbërëse e Doracakut “Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”, i cili aktualisht përmban proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Këto procedura standarde të operimit do të shërbejnë si procedura të brendshme për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, gjeodezia, lejet e ndërtimit, dokumentet e gjendjes civile, lejet, prona komunale, si procedura të brendshme për evidentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurive jo financiare kapitale dhe jo kapitale ashtu siç kërkohet me rregulla financiare.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga gjeodezia;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e ndërtimit;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga dokumentet e gjendjes civile;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga prona komunale;
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare nën 1,000€; dhe
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare kapitale mbi 1,000€.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, Drejtoria për Pronë dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës


Haki Rugova

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Istogut
Opština Istok / Municipality of Istog
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Ref: 01 nr 567/21 me datë 13.10. 2021

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe neni 68 të Statutit të Komunës së Istogut 01 nr. 62/10, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontollin, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, plotësim/ndryshimi i kapitullit të III-të “Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta”, si pjesë përbërëse e Doracakut “Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”, i cili përmban komponentët/proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Ky proces i është nënshtruar plotësim/ndryshimit si rezultat i ndryshimeve në kornizën ligjore, ku aktualisht procesi në fjalë rregullohet sipas: Ligjit për Prokurimin Publik 04/L-042, Ligjit për zyrtarët publik 06-L-114, Rregullës për prokurim të Shërbimeve të Veçanta (konsulentët/kontraktorët individual), si dhe Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik.

II. Pjesë përbërëse e këtij aneks vendimi është versioni i plotësuar/ndryshuar i kapitullit III “Procesi i kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta” të Doracakut “Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”.

III. Për zbatimin e këtij aneks vendimi do të kujdesen: Drejtoritë komunale, Zyra e Prokurimit dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.

IV. Aneks vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyra e prokurimit
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës



Haki Rugova

Kryetari i Komunës

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-566/021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-400-31073 të datës 09.08.2021 të parashtruar nga “Klubi i Hendbollit Istogu i Femrave” me seli në Istog, për përkrahje financiare për pjesmarrje në EHF Cup (përfaqesimin e Kosovës në Kupa të Evropës) dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** Kërkesa Nr.01-400-31073 e datës 09.08.2021 e parashtruar nga “Klubi i Hendbollit Istogu i Femrave” dhe i ndahen 5,315.00€ (pesëmijetreqindpesëmbëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit, për pjesmarrje në EHF Cup (përfaqesimin e Kosovës në Kupa të Evropës).
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e “Klubit i Hendbollit Istogu i Femrave” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

“Klubi i Hendbollit Istogu i Femrave”, ka parashtruar kërkesë me Nr.01-400-31073 të datës 09.08.2021, me të cilën ka kërkuar të përkrahet financiarisht për pjesmarrje në EHF Cup (përfaqesimin e Kosovës në Kupa të Evropës).

Kryetari shqyrtoi kërkesën e “Klubit i Hendbollit Istogu i Femrave” dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Për shkak të rëndësisë së pjesmarrjes së “Klubit i Hendbollit Istogu i Femrave”, për pjesmarrje në EHF Cup, përkrahet financiarisht me 5,315.00€ (pesëmijetreqindpesëmbëdhjetë euro).

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do t’i transferohen në xhirollogarinë e “Klubit i Hendbollit Istogu i Femrave”, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: “Klubi i Hendbollit Istogu i Femrave”, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-565/2021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-42418, të datës 01.10.2021, e parashtruar nga znj.Hamide Ahmetaj, nga fsh. Bellopojë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-42418, të datës 01.10.2021, e parashtruar nga znj.Hamide Ahmetaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e motres znj.Albiona Ahmetaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Hamide Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-42418, të datës 01.10.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Hamide Ahmetaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e motres znj.Albiona Ahmetaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapë konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: znj.Hamide Ahmetaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-564/2021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-7576, të datës 01.03.2021, e parashtruar nga z.Sahit Maksutaj, nga fsh.Orroberdë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-7576, të datës 01.03.2021, e parashtruar nga z.Sahit Maksutaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Sahit Maksutaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Sahit Maksutaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-7576, të datës 01.03.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Sahit Maksutaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Sahit Maksutaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Sahit Maksutaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-563/2021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-44106, të datës 11.10.2021, e parashtruar nga z.Arben Kerraj, nga fsh.Kashicë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-44106, të datës 11.10.2021, e parashtruar nga z.Arben Kerraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Arben Kerraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Arben Kerraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-44106, të datës 11.10.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Arben Kerraj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Arben Kerraj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Arben Kerraj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-562/2021	Data: Datum: 13.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-6048, të datës 15.02.2021, e parashtruar nga z.Regjep Sylaj, nga fsh.Staradran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e djalit të tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-6048, të datës 15.02.2021, e parashtruar nga z.Regjep Sylaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të djalit, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Regjep Sylaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Regjep Sylaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-6048, të datës 15.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim të djalit.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Qlirim Sylaj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Regjep Sylaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Regjep Sylaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-561/021	Data: Datum: 12.10.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit Zyra e Komunale për Komunitete dhe Kthim shqyrtoi kërkesën Nr.10-553-41014 të datës 24.09.2021 të parashtruar nga Bajram Memić, nga fsh Dobrushë, Komuna Istogut, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga ujqerit dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.10-553-41014 e datës 24.09.2021 e parashtruar nga Bajram Memić për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ujqerit që i kanë mbytur 12 dele dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqind euro)** nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim .
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Bajram Memić, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Bajram Memić, ka parashtruar kërkesën Nr.10-553-41014 të datës 24.09.2021 të parashtruar nga Bajram Memić j me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga ujqerit që i kanë mbytur 12 dele të races se bardhë franceze.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga ujqerit dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni pas shqyrtimit të procesverbalit të Inspektorit të Veterinës i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vlerësuar dëmin që fermerit ujqerit i kanë mbytur 12 dele të races se bardhë franceze në shumë prej **1,800.00€ (njëmijëetëqind euro)** dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim përkrahet fermeri në shumë prej **500.00€ (pesqind euro)**.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë delet.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Bajram Memić, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 560 /021	Data: Datum: 11.10.2021	

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) si dhe dispozitat e Rregullores (MF) -Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për organizim të aktivitetit: "16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë të aktivizmit kundër dhunës në familje" data 25.11.2021 deri 10.12.2021.
2. Për implementimin e thirrjes publike nga pika 1. e këtij Vendimi do të zbatohen dispozitat e Rregullores (MF) -Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare nga thirrja publike do të behët nga buxheti i administratës, kategoria e subvencioneve dhe transfereve.
4. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
5. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Drejtoria për Administratë Komunale, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete dhe një kopje në arkivin e Kryetarit.



Kryetari i Komunës
 z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-559/2021	Data: Datum: 08.10.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i Kanalizimit Fekal dhe Ndriçimit Publik ne lagjen Arif Ademi në Banjë Carrallukë dhe Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Istogut ”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6409-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-051-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i Kanalizimit Fekal dhe Ndriçimit Publik ne lagjen Arif Ademi në Banjë Carrallukë dhe Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Istogut ”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-6409-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-051-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Isa Hoxhaj,** Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Genc Ademaj,** Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për Partneritet Publiko Privat, anëtar dhe
- 1.3. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: “Ndërtimi i Kanalizimit Fekal dhe Ndriçimit Publik ne lagjen Arif Ademi në Banjë Carrallukë dhe Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Istogut ”; me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik qe kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-558/2021	Data: Datum: 08.10.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit 08.10.2021, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1“Instalimi i Kamerave në Institucioneve Shkollore të Komunës se Istogut”; Lot2 Dislokimi dhe Riinstalimi i Kabllot Optik për Kamerat e Sigurisë në Qytetin e Istogut”; nxjerr:

V E N D I M

- CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **Tahir Maksutaj**, Zyrtar për Monitorues të Kamerave në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Enver Rugova**, Drejtor i D.SH.P.M.SH për projektet: Lot1“Instalimi i Kamerave në Institucioneve Shkollore të Komunës se Istogut”; Lot2 Dislokimi dhe Riinstalimi i Kabllot Optik për Kamerat e Sigurisë në Qytetin e Istogut”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-4820-1-2-1/C503 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-043-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori dhe **“IMPACT” SH.P.K- Dega në Kosovë**
“ Cimi & ELECTRONIC” SH.P.K.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Tahir Maksutaj**, **Enver Rugova**, operatori **“IMPACT” SH.P.K- Dega në Kosovë** **“ Cimi 7&ELECTRONIC” SH.P.K** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.


 Zyrtar Kryesor Administrativ
Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-557/2021	Data: Datum: 08.10.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), me kërkesë të Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: "Palestra sportive në komunën e Istogut-faza finale", me numër të jashtëm prokurimi 633-19-3960-5-2-1/C 257 dhe me numër të brendshëm 633-019-048-521, nxjerr:

V E N D I M
